



Republika e Kosovës - Republic of Kosova  
Komuna - Municipality  
Hani i Elezit

Në bazë të nenet 11,12 paragrafi 3 dhe neni 58 pika h), të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040 dhe nenit 14, Plotësimi dhe Ndryshimi i të Statutit të Komunës së Hanit të Elezit, numër, 01/Nr.7703/2018, i datës 25.10.2018 dhe në bazë të shkresave të Drejtorisë për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport numër 05/1653/2023 dhe Drejtorisë së Zhvillimit Ekonomik, numër 08/1651/2023, Kuvendi i Komunës së Hanit të Elezit në mbledhjen e mbajtur më \_\_\_\_/\_\_\_\_/2023, miratoi këtë:

## PROPOZIM VENDIM

### PËR FORMIMIN E KOMISIONIT PËR PLOTËSIM DHE NDRYSHIM TË STATUTIT TË KOMUNËS

#### Neni 1

Me këtë propozim vendim formohet komisioni për Plotësim dhe Ndryshim të Statutit të komunës së Hanit të Elezit.

#### Neni 2

Komisioni do të ketë përbërjen nga: Kryetari apo nënkryetari i Komunës, Drejtori për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport, Drejtoresha për Zhvillim Ekonomi, Zyra Ligjore dhe nga një Përfaqësues të subjekteve Politike në Kuvendin e Komunës.

#### Neni 3

Plotësim ndryshimi i Statutit të komunës sipas propozimeve të dy drejtorive do të bëhet në nenin **67** Drejtoria për Zhvillim Ekonomik, ndryshohet në Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe **Turizëm**, gjithashtu shtohen kompetencat dhe detyrat e turizmit, ndërsa neni **63** Drejtoria për Arsim Kulturë Rini dhe Sport, ndahet **Drejtoria e Arsimit**, me kompetenca dhe detyra të Arsimit shtohet një nen tjetër dhe drejtori tjetër **Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport**.

#### Neni 4

Të bashkangjitur keni shkresën e Drejtorisë për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport me numër 05/1653/2023, të datës 22.02.2023 dhe Shkresën e Drejtorisë për Zhvillim Ekonomik, me numër 08/1651/2023, të datës 27.02.2023.

#### Neni 5

Propozim Vendimi hyn në fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi i Komunës së Hanit të Elezit dhe konfirmimit të Ligjshërisë nga MAPL.

Hani i Elezit  
Data: 13.03.2023



REPUBLICA E KOSOVES  
 REPUBLIKA KOSOVA  
 REPUBLIC OF KOSOVA  
 KOMUNA - OPSTINA / MUNICIPALITY  
 HANI I ELEZIT  
 Nr. i Prot. 05/1653  
 Nr. i Faq. \_\_\_\_\_ Data 27.02.2023



Republika e Kosovës / Republic of Kosovo  
 Komuna Hani i Elezit / Municipality of Hani i Elezit



**DREJTORIA PËR ARSIM KULTURË RINI DHE SPORT**

|       |   |
|-------|---|
| DATA  | 27.02.2023  |
| PËR   | Mehmet Ballazhi<br>Kryetar i Komunës së Hanit të Elezit     |
| NGA   | Hisni Luri<br>Drejtor për Arsim Kulturë Rini dhe Sport      |
| LËNDA | Kërkesë për ndryshimin dhe plotësimin e Statutit të Komunës |

I nderuar Kryetar,

Me anë të kësaj shkrese kërkoj nga ana juaj që të na lejoni fillimin e procedurave për ndryshimin dhe plotësimin e Statutit të Komunës së Hanit të Elezit!

Në si drejtori për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport kemi hasur në nevoja të mëdha për të ndryshuar këtë drejtori, duke iu ndarë edhe përgjegjësitë, kompetencat dhe buxhetin për të funksionuar në mënyrën më të mirë dhe duke iu përkushtuar secilës fushë. Arsimit vetmas, Kulturës, Rinisë dhe Sportit vetmas. Duke mos i përfshirë aktivitete e Kulturës, Rinisë dhe Sportit në Komunën e Hani të Elezit po mundohmi të listojmë disa aktivitete dhe punë që drejtorja e arsimit ka në përgjegjësi.

Drejtorja e arsimit si një dikaster tejet i gjërë dhe tejet i ngarkuar me shumë projekte dhe aktivitete në kuadër të kompetencave, autorizimeve dhe përgjegjësiave ligjore, udhëzimeve administrative të MASHT-it Statutit të Komunës dhe të politikave strategjike të Kryetarit të Komunës në fushën e veprimtarisë së saj, është kompetent dhe ka përgjegjësinë për menaxhimin dhe koordinimin e strukturës së arsimit publik parashkollor, fillor dhe të mesëm në Komunën e Hani të Elezit;

Udhëheq, menaxhon dhe koordinon procesin e licencimit të çdo institucioni edukativo-arsimor publik para-universitar, në përputhje me ligjet në fuqi dhe strategjinë e MASHT-it dhe të Komunës;

Bashkëpunon me Sektorin e Burimeve Njerëzore në procesin e punësimit të mësimitdhënësve dhe personelit tjetër (ndihmës dhe mbështetës), në pajtim me dispozitat e ligjeve në fuqi dhe me aktet nënligjore komunale dhe qendrore;

Bashkëpunon me Sektorin e Burimeve Njerëzore në procesin e përzgjedhjes së drejtorëve dhe zyrtarëve të institucioneve të arsimit publik parashkollor, fillor dhe të mesëm (0,1,2,3), në pajtim me ligjet dhe aktet nënligjore në fuqi;

Në përputhje me aktet ligjore në fuqi dhe në bashkëpunim me Sektorin e Pagave menaxhon procesin e pagesave të stafit aktiv arsimor dhe stafit tjetër profesional dhe mbështetës në institucionet shkollore-arsimore të Komunës së Hani të Elezit.

Në pajtim me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, planifikon dhe mbikëqyrë zbatimin e strategjive për arsimin parashkollor, fillor dhe të mesëm në Komunën e Hani të Elezit;

Mbikëqyrë institucionet arsimore dhe vlerëson performancën e të gjithë të punësuarit e drejtorisë dhe drejtuesve të institucioneve arsimore në nivel Komunal;

Regjistron dhe pranon nxënësit, në pajtim me parimin e mos-diskriminimit të të gjitha formave të tij.

Regjistron të gjitha të dhënat e nxënësve dhe evidenton, ruan dhe arkivon dosjet e personelit arsimor dhe trupit menaxherial, në përputhje me ligjet, procedurat dhe formularët e MASHTI;

Nxitë dhe promovon mundësitë për të ndjekur arsimin parashkollor, arsimin e obliguar fillor dhe atë të mesëm në kushte të barazisë së plotë për të gjithë;

Konstaton dhe identifikon nevojat për ngritje të vazhdueshme profesionale të drejtorëve dhe të personelit arsimor aktiv, në pajtim me dispozitat e ligjeve në fuqi dhe mundësitë reale buxhetore për to.

Organizon trajnime për mësimdhënësit dhe stafin tjetër profesional;

Harton, propozon dhe miraton rregulloret e punës për shkolla të të gjitha niveleve në kompetencë të Komunës, duke përfshirë Kodin e mirësjelljes për stafin udhëheqës, mësimdhënësit nxënësit dhe personelin tjetër mbështetës;

Merr vendime për ankesat kundër vendimeve të drejtorëve të shkollave të të gjitha niveleve para universitare në Komunë;

Monitoron dhe mbikëqyrë vendimet e drejtorëve të shkollave të të gjitha niveleve;

Monitoron të gjitha të hyrat dhe shpenzimet e Drejtorisë së Arsimit të Komunës së Hani të Elezit si organizatë buxhetore;

Mbikëqyrë shpenzimet e buxhetit, përmes kërkesës për raporte periodike nga shkollat;

Harton planin e prokurimeve për nevojat funksionale të Drejtorisë së Arsimit;

Në pajtim me aktet ligjore në fuqi, merr pjesë në procedurat e prokurimit të propozuara nga Drejtoria e Arsimit deri në vlerësimin e ofertave (së paku një anëtar në komision për vlerësimin përfundimtar të ofertave);

Në këshillim me drejtorët e shkollave dhe të këshillave drejtuese të shkollave miraton rregulloret për sjelljen dhe disiplinën e nxënësve;

Konstaton dhe identifikon si dhe propozon në marrëveshje me MASHT-in vendimin për themelimin, shuarjen, ndarjen apo mbylljen e institucioneve shkollore publike të niveleve 0,1,2 dhe 3 në Komunën e Hani të Elezit;

Nxit, ndihmon dhe inicion bashkëpunimin në mes mësimeve prindërore, nxënësve, me qëllim të ngritjes së kualitetit dhe cilësisë së mësimit dhe mësimit-nxënies në shkollat të cilat i menaxhon dhe mbikëqyr (shkollat publike).

Organizon, inkurajon dhe nxitë organizimin e garave të ndryshme të diturisë në mes të shkollave, nga lëndët e shkencave natyrore dhe atyre humanitare dhe ndan shpërblime dhe mirënjohje për nxënësit dhe punëtorët arsimor të merituar;

Kujdeset për mirëmbajtjen dhe renovimin e objekteve shkollore dhe të pajisjeve të institucioneve arsimore me fonde publike.

Kujdeset, inicion dhe organizon krijimin e shërbimeve të nevojshme për nxënësit dhe mirëqenien e tyre (ujin, ambient banjash, shërbime shëndetësore, shujta ditore etj.);

Kujdeset për mirëmbajtjen e ambienteve rrethuese të shkollave duke promovuar gjelbërimin e tyre;

Propozon dhe inicion bashkëpunimet ndër-komunale në fushën e arsimit;

Bashkëpunon me OJQ dhe shoqërië civile si dhe me organizata qeveritare dhe jo qeveritare me qëllim të tërheqjes së donacioneve në interes të shkollave publike të të gjitha niveleve para-universitare me qëllim të avancimit dhe ngritjes së kualitetit të mësimit dhe mësimit-nxënies;

Për arritjen e objektivave të shëndetit publik ndërmerr aktivitete dhe zhvillon programe të përbashkëta me MASHT dhe shkollat për të nxitur kujdesin shëndetësor dhe shmangur smundejve ngjitëse dhe dukurive devejante;

Kujdeset dhe mbështet arsimimin e fëmijëve me nevoja të veçanta (speciale), në përputhje me masën dhe nevojat specifike të tyre;

Kryen edhe punë të tjera, në përputhje me ligjet e aplikueshme në kuadër të fushë veprimtarisë së Drejtorisë.

Për të gjitha funksionet të përcaktuara me dispozitat ligjore në fuqi, Drejtoria është e organizuar në këta sektorë gjë që mendojmë se janë të pa mjaftuar për ti përmbushur nevojat si drejtori edhe për aktivitet kulturorë, historike, trashëgimisë kulturore, rinore dhe atyre sportive.

Organizimi i DKARS-së në këta sektorë aktualisht është:

1. Shef i Arsimit.
2. Zyrtare ligjore për nevoja të drejtorisë
3. Zyrtar i bibliotekës
4. Zyrtar për Kulturë

Me shumë respekt,

Hisni Luri  
Drejtor për Arsim Kulturë Rinë dhe Sport





Republika e Kosovës / Republic of Kosovo  
Komuna Hani i Elezit / Municipality of Hani i Elezit



### DREJTORIA PËR ZHVILLIM EKONOMIK

|       |  |
|-------|--|
| DATA  | 24.02.2023   |
| PËR   | <i>për</i> Mehmet Ballazhi<br>Kryetar i Komunës së Hanit të Elezit |
| NGA   | Majlinda Kaloshi<br>Drejtoreshë për Zhvillimi Ekonomik             |
| LËNDA | Kërkesë për ndryshimin dhe plotësimin e Statutit të Komunës        |


I nderuar Kryetar,

Me anë të kësaj shkrese kërkoj nga ana juaj që të na lejoni fillimin e procedurave për ndryshimin dhe plotësimin e Statutit të Komunës së Hanit të Elezit!

Gjatë udhëheqjes së Drejtorisë për Zhvillim Ekonomik ne kemi hasur që nevoja për ndryshim të emërimit dhe përgjegjësi të së njëjtës të plotësohen dhe të shtohen kompetencat duke themeluar në kuadër të saj edhe sektorin e Turizmit, sepse kjo e fundit është në mungesë tek departamentet tona. Me marrjen e këtyre kompetencave fokusi i Drejtorisë do të jetë edhe nga kjo fushë me qëllim të zhvillimit të hovshëm në vend duke shfrytëzuar potencialet që ka!

Propozohet që emërtimi i Drejtorisë të caktohet në: “Drejtoria e Zhvillim Ekonomik dhe Turizmit”, ndërsa tek përgjegjësitë, propozohet që të shtohen edhe ato të mbulueshmërisë së kësaj pjese!

Me shumë respekt,

  
Majlinda Kaloshi  
Drejtoreshë për Zhvillim Ekonomik